

UDHËZIM
Nr. 9, datë 26.3.2021

**PËR SAKTËSIMIN E PROCEDURAVE PËR PËRJASHTIMIN NGA TATIMI MBI
VLERËN E SHTUAR DHE DETYRIMET E TJERA NË IMPORT TË FURNIZIMIT
TË MALLRAVE E SHËRBIMEVE, TË LIDHURA ME NDËRTIMIN DHE
FUNKSIONIMIN E SPITALIT DERI NË DATËN E DHURIMIT TË TIJ, I CILI DO
TË NDËRTOHET NGA QEVERIA E REPUBLIKËS SË TURQISË NË FIER,
SHQIPËRI**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të ligjit nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; dhe të ligjit nr. 23/2021, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë mbi dhurimin në fushën e shëndetësisë”, ministri i Financave dhe Ekonomisë

UDHËZON:

Neni 1
Qëllimi i udhëzimit

Ky udhëzim ka për qëllim të përcaktojë rregullat dhe procedurat që do të ndiqen për përjashtimin nga tatimi mbi vlerën e shtuar dhe detyrimet e tjera në import të furnizimit të mallrave dhe shërbimeve, sipas ligjit nr. 23/2021, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë mbi dhurimin në fushën e shëndetësisë”.

Neni 2
Fusha e veprimit

Në zbatim të ligjit nr. 23/2021, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë, mbi dhurimin në fushën e shëndetësisë”, përjashtohet nga TVSH-ja dhe detyrimet doganore/taksat e tjera në import:

- a) importimi i të gjitha llojeve të pajisjeve mjekësore, pajisjeve, orendive dhe materialeve të ndërtimit, siç sigurohen nga pala turke dhe siç tregohet në shtojcën bashkëlidhur marrëveshjes për spitalin me 150 shtretër që do të ndërtohet në Fier, Shqipëri;
- b) furnizimi brenda vendit i mallrave dhe i shërbimeve për ndërtimin dhe funksionimin deri në datën e dhurimit të spitalit nga pala turke për palën shqiptare;
- c) importimi i mallrave, materialeve dhe pajisjeve nga pala turke për ndërtimin dhe funksionimin e spitalit.

Neni 3
Subjektet e përjashtuara nga TVSH-ja

Subjektet e përjashtuara nga TVSH-ja, në kuadër të procesit të ndërtimit të spitalit në Fier, Shqipëri nga pala turke, janë:

a) shoqëria “YDA Insaat Sanayi ve Ticaret Anonim Sirketi, dega Shqipëri” me numër identifikimi të personit të tatueshëm (NIPT) M12522403G, e cila është caktuar nga pala turke për kryerjen e punimeve për ndërtimin e spitalit;

b) nënkontraktorët/furnizuesit e shoqërisë “YDA Insaat Sanayi ve Ticaret Anonim Sirketi, dega Shqipëri”, të deklaruar në listën e dërguar nga kjo shoqëri pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Neni 4

Procedura dhe mënyra e zbatimit të përjashtimit

Shoqëria “YDA Insaat Sanayi ve Ticaret Anonim Sirketi, dega Shqipëri”, për qëllim të zbatimit të këtij udhëzimi, duhet të përcjellë zyrtarisht në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dokumentacionin si më poshtë:

a) kërkesën me shkrim, së cilës i bashkëngjitet një fotokopje e certifikatës së NIPT/NUIS-it;

b) marrëveshjen e lidhur me palën turke për ndërtimin e spitalit në Fier, e cila duhet të jetë në gjuhën shqipe dhe e njësuar me origjinalin;

c) preventivin e punimeve, i cili duhet të jetë i ndarë në zëra, në sasi dhe në vlerë, ku të detajohet lista e materialeve që do të përdoren në procesin e ndërtimit;

d) listën e të gjithë nënkontraktorëve/furnizuesve të përfshirë në procesin e ndërtimit të spitalit në Fier;

e) fotokopje të certifikatës së NIPT/NUIS-it për secilin nënkontraktor/furnizues;

f) preventivin, në të cilin duhet të jenë përcaktuar qartë mallrat dhe shërbimet e lidhura me secilin nënkontraktor/furnizues, i cili duhet të jetë i ndarë në zëra, në sasi dhe në vlerë.

Lista e nënkontraktorëve/furnizuesve mund të përditësohet nga shoqëria sa herë çmohet e nevojshme, duke informuar detyrimisht edhe Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, brenda 5 (pesë) ditëve pune, nga data e dorëzimit të dokumentacionit, shqyrton kërkesën e paraqitur nga shoqëria “YDA Insaat Sanayi ve Ticaret Anonim Sirketi, dega Shqipëri”.

Bazuar në rezultatet e shqyrtimit, kur përmbushen kërkesat e përcaktuara dhe është plotësuar dokumentacioni i sipërpërmendur, drejtori i përgjithshëm i Tatimeve, brenda 3 (tre) ditëve pune nga paraqitja e kërkesës, shprehet lidhur me aprovimin e përjashtimit sipas kërkesës.

Një kopje e aprovimit, së bashku me dokumentacionin e dërguar nga kjo shoqëri, i përcillet Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier, e cila ka në administrim shoqërinë “YDA Insaat Sanayi ve Ticaret Anonim Sirketi, dega Shqipëri”. Gjithashtu, kopja e aprovimit, së bashku me dokumentacionin, i dërgohet Drejtorisë Rajonale Tatimore, që ka në administrim nënkontraktorin/furnizuesin e përcaktuar në listën e dërguar nga shoqëria “YDA Insaat Sanayi ve Ticaret Anonim Sirketi, dega Shqipëri”.

Nënkontraktorët/furnizuesit e shoqërisë “YDA Insaat Sanayi ve Ticaret Anonim Sirketi, dega Shqipëri”, të përcaktuar në listën e dërguar nga kjo shoqëri pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, janë të përjashtuar nga TVSH-ja si në blerje ashtu edhe në shitje dhe nuk aplikojnë TVSH-në për të gjitha furnizimet e mallrave apo të shërbimeve të kryera dhe të lidhura me ndërtimin apo funksionimin e spitalit në Fier, deri në datën e dhurimit të tij nga pala turke për palën shqiptare. Bazuar në dispozitat e neneve 60–70, të ligjit nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, për të tilla furnizime të lidhura me ndërtimin apo funksionimin e spitalit të Fierit, nënkontraktorët/furnizuesit kreditojnë tatimin e paguar në blerje.

Nënkontraktorët/furnizuesit e shoqërisë “YDA Insaat Sanayi ve Ticaret Anonim Sirketi, dega Shqipëri”, të përcaktuar në listën e dërguar nga kjo shoqëri pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, të cilët i importojnë vetë mallrat, materialet apo pajisjet që do të përdoren prej tyre për

procesin e ndërtimit të spitalit, paraqiten pranë autoritetit doganor për të përfituar përjashtimin në import për mallrat e përcaktuara në kontratën dhe preventivin e dërguar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve nga shoqëria “YDA Insaat Sanayi ve Ticaret Anonim Sirketi, dega Shqipëri”.

Drejtori i përgjithshëm i Tatimeve miraton procedurë/manual të posaçëm, me qëllim kontrollin e zbatimit të përjashtimeve, në përputhje me legjislacionin për tatimin mbi vlerën e shtuar.

Neni 5

Përjashtimi në import

Mallrat, materialet dhe pajisjet e importuara nga ana e shoqërisë “YDA Insaat Sanayi ve Ticaret Anonim Sirketi, dega Shqipëri”, për ndërtimin dhe funksionimin e spitalit përjashtohen nga detyrimet doganore, taksat e tjera dhe TVSH-ja në import.

Neni 6

Përjashtime të tjera

Të gjitha furnizimet e tjera të lidhura drejtpërdrejt me ndërtimin dhe funksionimin e spitalit deri në datën e dhurimit të tij nga pala turke për palën shqiptare, janë furnizime të përjashtuara nga TVSH-ja.

Neni 7

Plotësimi i faturës

Furnizuesit e mallrave dhe të shërbimeve të përjashtuara nga TVSH-ja sipas këtij vendimi, në momentin e lëshimit të faturës tatimore, duhet të shënojnë në faturë dispozitën ligjore, sipas së cilës furnizimi është i përjashtuar.

Neni 8

Organet zbatuese

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Neni 9

Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
Anila Denaj

Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 49, datë 29.03.2021